



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 241/ Prot.
41

Tiranë, më 04.09.2023

UDHËZIM

Nr. 2, datë 04.04.2024

PËR

**DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 25. 03.2024 "PËR
PROCEDURAT E PRANIMIT DHE REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E
SPECIALIZIMEVE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË, NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024"**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutit dhe Rregullores së UMT-së, Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, e përditësuar, si dhe në Vendimin Qarkullues nr. 44, datë 03.04.2024 "Për një ndryshim në Vendimin Qarkullues nr. 35, datë 25.03.2024 "Për miratimin e shpërndarjes së kuotave të pranimit dhe tarifave të shkollimit, në programet e ciklit të tretë të studimeve, specializimeve afatgjata, në fushën e mjekësisë, për vitin akademik 2023-2024, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë" të Senatit Akademik,

UDHËZOJ:

1. Në Udhëzimin nr. 1, datë 25. 03.2024 "Për procedurat e pranimit dhe regjistrimit në programet e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2023-2024" bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pika 4, riformulohet si më poshtë:

"4. Për të aplikuar në programet e specializimit afatgjata për të cilat janë parashikuar kuota, sipas tabelës bashkëlidhur Vendimit qarkullues nr. 35, datë 25.03.2024 dhe Vendimit qarkullues nr. 44, datë 03.04.2024 të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, kandidatët duhet të kenë përfunduar një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në fushën e mjekësisë.

Të gjithë kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e parashikuara në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë."

b) Pika 20, riformulohet si më poshtë:

"20. Transferimet e studimeve do të kryhen në zbatim të Vendimit Qarkullues nr. 35, date 25.03.2024, pika 4 dhe Vendimit Qarkullues nr. 44, datë 03.04.2024 Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Kandidati, në momentin e aplikimit, veç sa është parashikuar në pikën 5 të këtij udhëzimi, dorëzon dhe kopje të noterizuar të dokumentacionit, si më poshtë:

- a. Planin e plotë të programit të studimit specializues të ndjekur;*
- b. Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, si dhe syllabuset përkatëse për lëndët e shlyera, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur dhe/ ose vërtetim vlerësimi për periudhat e praktikave dhe frekuentimin e aktiviteteve të parashikuara në programin e specializimit të ndjekur.*

Aplikimet për transferimin e studimeve shqyrtohen nga Komisioni i Vlerësimit në të njëjtat data me pikantët e tjerë të përcaktuara në këtë udhëzim.

Kandidati transferohet në vit të pare ose të dytë, por jo më lart se viti i dytë i studimeve. Kandidatet që plotësojnë kriteret për tu transferuar, vlerësohen për periudhën e specializimit të kryer dhe ekuivalentimin e saj, si dhe krediteve të përfituara gjatë studimeve të mëparshme duke i përcaktuar vitin se ku mund të transferohet eventualisht kandidati.

Kandidatët që kërkojnë të transferohen nga programe specializimi, sipas pikës 4.1 të Vendimit Qarkullues nr. 44, datë 03.04.2024 të Senatit Akademik të UMT-së, duhet të marrin miratimin paraprak për transferim nga Ministria përgjegjëse për shëndetësinë me të cilën është lidhur kontrata e mëparshme. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë shprehet gjithashtu për rastet kur kandidatët kërkojnë të transferohen nga një program specializimi për të cilin nuk kanë lidhur kontrate me këtë ministri në një program specializimi që parashikon kuote transferimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Regjistrimi i kandidatëve që transferohen në programet e specializimit afatgjatë ku janë shpallur fitues behët brenda 7 ditëve nga data e shpalljes. kandidatët që do të regjistrohen në kuadër të kuotave të transferimit duhet të dorëzojnë dhe dokumentin e çregjistrimit nga programi i specializimit nga ku transferohen.

2. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë dhe për njohje Ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

